



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 1, datë 08.02.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 230 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratohet Rregullorja e Brendshme e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian Dvorani

